

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: : **KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**

Nr i Prokurimit **613-26-4194-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **Perfundimi i puneve ne sallen e sportit ne kuader te SHFMU Ismail Luma ne Lipjan**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NNP''CTA''SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

rr.Mehmet Gradica hy2 nr6

(Adresa)

Prishtine

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

+383-44-507719

(Numri Telefonit)

(Numri)

ZIJA MORINA

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nnpcta@gmail.com

(Adresa elektronike)



08.07.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin **Perfundimi i puneve ne sallën e sportit ne kuader te SHFMU Ismail Luma ne Lipjan**

Njoftimi për kontrate është bërë me datën 10.06.2026

KERKESA PER RISHQYRTIM PER KRITERET E TENDERIT ESHTË BERE ME DATE 26.06.2026

VENDIMI I AK LIDHUR M EKERKESËN PER RISHQYRTIM DATE 29.06.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Hapja është bërë në platformën e prokurimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Me datën **26.06.2026** kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim per NJOFTIMIN PER KONTRATE -kriteret diskriminuuese . AK ka shqyrtuar kërkesën tonë dhe me datën **29.06.2026** na ka dërguar vendimin lidhur me këtë shqyrtim ku sipas këtij vendimi AK ka pjesrisht i bazur dhe me date 29.06.2026 ka publikur B54 Në përputhje me LPP-në dhe brenda afatit ligjor ne i drejtohemi OSHP-së me këtë ankesë kundër vendimit të AK.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjate vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka zbatuar me përpikëri të gjitha dispozitat e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Përpos kësaj AK nuk ka respektuar as kërkesat e dosjes së tenderit të cilat vetë i ka parashtruar në fillim të këtij procesi të prokurimit. Dispozitat që ne mendojmë se AK i ka shkelur janë:

- **Neni 7, paragrafët 1, 2 dhe 3 të LPP-së**
- **Neni 9, paragrafi 1 i LPP-së**
- **Neni 28, paragrafët 2 dhe 7 të LPP-së**
- **Neni 51, paragrafi 1 i LPP-së**
- **Neni 19.16 i Rregullores**
- **Nenet 25.17 dhe 25.18 të Rregullores**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi 1

Kërkesa e AK-së: Në Kërkesën 3 të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar: “**Dumper vetëshkarkues në 3 anët i pajisur me kran dhe lugë ngarkuese min. 4T = min. 1 copë**”.

Dëshmia e kërkuar: Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe vulosur, dokumentet e pronësisë/posedimit ose marrëveshje qiraje në emër të projektit.

Arsyet e kontestimit:

Kërkesa është e panevojshme, jo proporcionale dhe kufizuese për konkurrencën, pasi Autoriteti Kontraktues ka kërkuar një pajisje shumë specifike me disa funksione të kombinuara në një makineri të vetme.

Konkretisht, kjo pajisje është kërkuar me së paku **tri funksione të kombinuara:**

1. **vetëshkarkim në tri anë,**
2. **ngritje/manipulim me kran,**
3. **ngarkim me lugë ngarkuese.**

Paramasa ofertuese nuk e arsyeton domosdoshmërinë që këto funksione të jenë të integruara në një pajisje të vetme. Për më tepër, duke qenë se kemi të bëjmë me fazën e dytë të punimeve, ku punët kryesore janë suvatim, gletim, fasadë, ngjyrosje, ventilim, panele sendviç, instalime elektrike dhe ngrohje qendrore, nuk ka bazë teknike që të kërkohej një pajisje e tillë e rëndë dhe e kombinuar.

Në këtë fazë nuk ka demolim, thyerje të rënda, gërmime masive apo volum të madh të punëve të betonit dhe armaturës që do ta arsyetonin një dumper të tillë me kran dhe lugë ngarkuese.

Kjo kërkesë nuk mat aftësinë reale teknike të operatorëve ekonomikë, por i kushtëzon ata me posedimin e një pajisjeje të veçantë, me konfigurim të ngushtë dhe të rrallë në treg.

Sipas verifikimeve të operatorit ekonomik, kjo pajisje është shumë e rrallë në tregun e Kosovës dhe ekziston vetëm një pajisje e këtij lloji, gjë që e bën kërkesën dukshëm kufizuese dhe potencialisht favorizuese për operatorin që e posedon atë.

Shkeljet ligjore:

Neni 7, paragrafët 1, 2 dhe 3 të LPP-së – kufizim dhe reduktim i konkurrencës;

Neni 9, paragrafi 1 i LPP-së – kërkesa nuk rezulton nga nevojat reale të projektit;

Neni 28, paragrafët 2 dhe 7 të LPP-së – specifikim i ngushtë teknik dhe jo funksional;

Neni 51, paragrafi 1 i LPP-së – kriter i panevojshëm për aftësinë teknike;

Neni 19.16 i Rregullores – rrezik favorizimi i operatorëve të caktuar;

Nenet 25.17 dhe 25.18 të Rregullores – kërkesë jo relevante dhe jo proporcionale me objektin e kontratës.

Kërkesa:

Kërkoheq që të largohet në tërësi kërkesa për:

“Dumper vetëshkarkues në 3 anët i pajisur me kran dhe lugë ngarkuese min. 4T = min. 1 copë”,

pasi kjo kërkesë është e panevojshme, tepër specifike, jo proporcionale me fazën e dytë të punimeve dhe ka efekt kufizues ndaj konkurrencës. Poashtu është I parapare edhe një pasije tjetër **Dumper vetëshkarkues në 3 anet**

Pretendimi 2

Kërkesa e AK-së:

Në Kërkesën 3 të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar:

“Eskavator robotik max. 500 kg = min. 1 copë”.

Dëshmia e kërkuar:

Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe vulosur, dokumentet e pronësisë/posedimit ose marrëveshje qiraje në emër të projektit.

Arsyet e kontestimit:

Kërkesa është shumë specifike dhe nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me pozicionet e paramasës ofertuese.

Kjo pajisje nuk është kërkesë për një pajisje të zakonshme ndërtimore, por për një pajisje shumë të specializuar, e cila zakonisht përdoret për punë të veçanta si demolim, thyerje apo ndërhyrje në hapësira të kufizuara.

Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me pajisje me disa funksione të zakonshme të ndara, por me një **pajisje shumë specifike dhe të specializuar**, përdorimi i së cilës nuk arsyetohet me paramasën ofertuese.

Në paramasë nuk janë paraparë punë të specializuara demolimi, thyerjeje apo gërmimi në hapësira të kufizuara që do ta bënin të domosdoshme përdorimin e një eskavatori robotik max. 500 kg.

Duke qenë se objekti është në fazën e dytë të punimeve dhe punimet janë kryesisht suvatim, gletim, fasadë, ngjyrosje, ventilim, panele sendviç, instalime elektrike dhe ngrohje qendrore, kërkesa për këtë pajisje është e panevojshme dhe jo proporcionale.

Pajisja e tillë pothuajse mungon në tregun e Kosovës. Sipas verifikimeve të operatorit ekonomik, në Kosovë ekziston vetëm **një pajisje e këtij lloji**, gjë që e bën kërkesën dukshëm kufizuese dhe potencialisht favorizuese për operatorin ekonomik që e posedon atë.

Shkeljet ligjore:

Neni 7, paragrafët 1, 2 dhe 3 të LPP-së – kufizim dhe reduktim i konkurrencës;

Neni 9, paragrafi 1 i LPP-së – kërkesa nuk rezulton nga nevojat reale të projektit;

Neni 28, paragrafët 2 dhe 7 të LPP-së – specifikim i ngushtë teknik dhe jo funksional;

Neni 51, paragrafi 1 i LPP-së – kriter i panevojshëm për aftësinë teknike;

Neni 19.16 i Rregullores – rrezik favorizimi;

Nenet 25.17 dhe 25.18 të Rregullores – kërkesë jo relevante dhe jo proporcionale me objektin e kontratës.

Kërkesa:

Kërkohet që të largohet në tërësi kërkesa për:

“Eskavator robotik max. 500 kg = min. 1 copë”,

pasi kërkesa nuk është e arsyetuar me pozicionet konkrete të paramasës, nuk lidhet me natyrën reale të punimeve të fazës së dytë dhe ka efekt kufizues ndaj konkurrencës.

Pretendimi 3

Kërkesa e AK-së: Në Kërkesën 3 të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar: **“Cilindër me dhëmbëza i pajisur edhe me lugë për nivelizim max. 4T = min. 1 copë”.**

Dëshmia e kërkuar: Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe vulosur, dokumentet e pronësisë/posedimit ose marrëveshje qiraje në emër të projektit.

Arsyet e kontestimit:

Kërkesa është jo proporcionale dhe kufizuese, pasi Autoriteti Kontraktues ka kërkuar një pajisje me **dy funksione të kombinuara** në një makineri të vetme:

1. ngjeshje me cilindër me dhëmbëza,
2. nivelizim me lugë.

Paramasa ofertuese nuk e arsyeton domosdoshmërinë që këto dy funksione të kryhen patjetër nga e njëjta pajisje. Kërkimi i cilindrit me dhëmbëza të pajisur edhe me lugë për nivelizim është konfigurim i ngushtë teknik dhe jo funksional.

Duke qenë se kemi të bëjmë me fazën e dytë të punimeve, nuk ka punë të rënda infrastrukturore, ngjeshje të sipërfaqeve të mëdha, punë të mëdha betoni apo përgatitje masive terreni që do ta arsyetonin këtë pajisje.

Punimet kryesore janë suvatim, gletim, fasadë, ngjyrosje, ventilim, panele sendviç, instalime elektrike dhe ngrohje qendrore, prandaj kërkesa për cilindër me dhëmbëza me lugë për nivelizim është e panevojshme dhe e tepruar.

Kërkesa nuk mat aftësinë reale teknike të operatorëve ekonomikë, por vendos kusht posedimin e një konfigurimi të veçantë të pajisjes.

Shkeljet ligjore:

Neni 7, paragrafët 1, 2 dhe 3 të LPP-së – kufizim dhe reduktim i konkurrencës;

Neni 9, paragrafi 1 i LPP-së – kërkesa nuk rezulton nga nevojat reale të projektit;

Neni 28, paragrafët 2 dhe 7 të LPP-së – specifikim i ngushtë teknik dhe jo funksional;

Neni 51, paragrafi 1 i LPP-së – kriter i panevojshëm për aftësinë teknike;

Neni 19.16 i Rregullores – rrezik favorizimi;

Nenet 25.17 dhe 25.18 të Rregullores – kërkesë jo relevante dhe jo proporcionale me objektin e kontratës.

Kërkesa:

Kërkohet që të largohet në tërësi kërkesa për:

“Cilindër me dhëmbëza i pajisur edhe me lugë për nivelizim max. 4T = min. 1 copë”,

pasi nuk është e nevojshme për fazën e dytë të punimeve dhe nuk është e lidhur drejtpërdrejt me pozicionet konkrete të paramasës ofertuese.

Në alternativë, kërkesa të riformulohet në mënyrë funksionale dhe jo kufizuese si:

“Pajisje adekuate për ngjeshje dhe nivelizim, duke lejuar pajisje ekuivalente”.

Pretendimi 4

Kërkesa e AK-së:

Në Kërkesën 3 të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar:

“Lugë ngarkuese me pirun dhe fshesë = min. 1 copë”.

Dëshmia e kërkuar:

Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe vulosur, dokumentet e pronësisë/posedimit ose marrëveshje qiraje në emër të projektit.

Arsyet e kontestimit:

Kërkesa është e ngushtë, kufizuese dhe jo proporcionale me objektin e kontratës, pasi Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar vetëm lugë ngarkuese, por ka kërkuar një pajisje me **tri funksione/elemente të kombinuara** në një makineri të vetme:

1. **ngarkim me lugë ngarkuese,**
2. **bartje/manipulim me pirun,**
3. **pastrim/fshirje me fshesë.**

Paramasa ofertuese nuk e arsyeton domosdoshmërinë që luga ngarkuese të jetë e pajisur patjetër edhe me pirun dhe fshesë. Kërkesa për lugë ngarkuese mund të jetë e pranueshme për funksionin bazë të ngarkimit, mirëpo kushtëzimi që ajo të jetë edhe me pirun dhe fshesë është i panevojshëm dhe kufizues.

Duke qenë se bëhet fjalë për fazën e dytë të punimeve, ku punët kryesore janë suvatim, gletim, fasadë, ngjyrosje, ventilim, panele sendviç, instalime elektrike dhe ngrohje qendrore, Autoriteti Kontraktues nuk ka dëshmuar se ekziston nevojë teknike për një konfigurim të tillë me pajisje shtesë.

Kërkesa në këtë formë nuk mat aftësinë reale teknike të operatorëve ekonomikë, por vendos kusht posedimin e një pajisjeje me konfigurim të veçantë, që është më kufizuese sesa nevoja reale e projektit.

Shkeljet ligjore:

Neni 7, paragrafët 1, 2 dhe 3 të LPP-së – kufizim dhe reduktim i konkurrencës;

Neni 9, paragrafi 1 i LPP-së – kërkesa nuk rezulton nga nevojat reale të projektit;

Neni 28, paragrafët 2 dhe 7 të LPP-së – specifikim i ngushtë teknik dhe jo funksional;

Neni 51, paragrafi 1 i LPP-së – kriter i panevojshëm për aftësinë teknike;

Neni 19.16 i Rregullores – rrezik favorizimi i operatorëve të caktuar;

Nenet 25.17 dhe 25.18 të Rregullores – kërkesë jo relevante dhe jo proporcionale me objektin e kontratës.

Kërkesa:

Kërkohet që kërkesa për:

“Lugë ngarkuese me pirun dhe fshesë = min. 1 copë”

të riformulohet duke larguar pjesën kufizuese “**me pirun dhe fshesë**”, dhe të mbetet vetëm:

“Lugë ngarkuese = min. 1 copë”.

Ky riformulim do ta lidhte kërkesën me nevojën reale funksionale të projektit, përkatësisht me funksionin e ngarkimit, pa kushtëzuar operatorët ekonomikë me pajisje shtesë të panevojshme.

Pretendimi 5

Kërkesa e AK-së:

Në Kërkesën 3 të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar:

“Kompresor gjysmë rimorkio që tërhiqet min. 1.5 T = min. 1 copë”.

Dëshmia e kërkuar:

Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe vulosur, dokumentet e pronësisë/posedimit ose marrëveshje qiraje në emër të projektit.

Arsyet e kontestimit:

Kërkesa për kompresor gjysmë rimorkio që tërhiqet me peshë minimale 1.5 T është e panevojshme, e tepruar dhe jo proporcionale me objektin e kontratës.

Kjo pajisje nuk është problematike për shkak të kombinimit të disa funksioneve, por për shkak të kapacitetit dhe peshës së lartë të kërkuar, përkatësisht **min. 1.5 T**.

Në paramasën ofertuese nuk janë paraparë punë të specializuara demolimi, thyerjeje të rëndë apo ndërhyrje të tilla që do ta arsyetonin domosdoshmërinë e një kompresori gjysmë rimorkio me këtë kapacitet dhe peshë.

Duke qenë se objekti është në fazën e dytë të punimeve dhe nuk kemi të bëjmë me demolim apo punë të rënda betoni/armature, kërkesa për kompresor gjysmë rimorkio min. 1.5 T nuk është e lidhur me nevojat reale të projektit.

Punimet e parapara janë kryesisht punime përfundimtare dhe instalative, si suvatim, gletim, fasadë, ngjyrosje, ventilim, panele sendviç, elektrike dhe ngrohje qendrore. Për këto punime nuk është e arsyetuar kërkesa për pajisje të rëndë të këtij kapaciteti.

Vendosja e kufirit “**min. 1.5 T**” e ngushton konkurrencën në mënyrë të panevojshme, pasi për punimet e parapara mund të përdoren pajisje më të lehta, më praktike dhe më proporcionale me natyrën reale të punimeve.

Shkeljet ligjore:

Neni 7, paragrafët 1, 2 dhe 3 të LPP-së – kufizim dhe reduktim i konkurrencës;

Neni 9, paragrafi 1 i LPP-së – kërkesa nuk rezulton nga nevojat reale të projektit;

Neni 28, paragrafët 2 dhe 7 të LPP-së – specifikim i ngushtë teknik dhe jo funksional;

Neni 51, paragrafi 1 i LPP-së – kriter i panevojshëm për aftësinë teknike;

Neni 19.16 i Rregullores – rrezik favorizimi i operatorëve të caktuar;

Nenet 25.17 dhe 25.18 të Rregullores – kërkesë jo relevante dhe jo proporcionale me objektin e kontratës.

Kërkesa:

Kërkohet që kërkesa për:

“Kompresor gjysmë rimorkio që tërhiqet min. 1.5 T = min. 1 copë”

të largohet në tërësi nga Dosja e Tenderit, pasi në paramasën ofertuese nuk ka punë demolimi, thyerje apo punime të tjera të rënda që do ta arsyetonin nevojën për një kompresor me kapacitet dhe peshë kaq të lartë.

Në alternativë, nëse Autoriteti Kontraktues vlerëson se kompresori është i nevojshëm, kërkesa duhet të riformulohet si vijon:

“Kompresor adekuat për realizimin e punimeve, me peshë deri në max. 1.5 T = min. 1 copë”.

Ky riformulim do ta shmangte kufizimin e panevojshëm të konkurrencës dhe do ta lidhte kërkesën me nevojat reale të projektit.

Pretendimi 6

Kërkesa e AK-së:

Në Kërkesën 3 të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar:

“Gjysmë rimorkio lift për bartje të materialeve = min. 1 copë”.

Dëshmia e kërkuar:

Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe vulosur, dokumentet e pronësisë/posedimit ose marrëveshje qiraje në emër të projektit.

Arsyet e kontestimit:

Kërkesa është e ngushtë dhe kufizuese, pasi Autoriteti Kontraktues e ka kufizuar bartjen dhe ngarkim-shkarkimin e materialeve vetëm në **gjysmë rimorkio lift**.

Kjo pajisje është kërkuar me **dy funksione kryesore:**

1. **bartje të materialeve,**
2. **ngarkim-shkarkim/ngritje me lift.**

Problemi kryesor është se AK-ja e ka kufizuar kërkesën vetëm në një lloj të caktuar të mjetit, pra vetëm në gjysmë rimorkio lift, ndërsa i njëjti funksion mund të kryhet edhe me **kamion me lift**.

Për realizimin e punimeve të parapara në paramasën ofertuese, bartja dhe ngarkim-shkarkimi i materialeve mund të kryhen në mënyrë të përshtatshme edhe me kamion me lift, i cili e përmbush të njëjtin funksion teknik dhe praktik.

Duke qenë se bëhet fjalë për fazën e dytë të punimeve, ku nuk ka demolim, thyerje, gërmime të rënda apo volum të madh të punëve të betonit dhe armaturës, kërkesa për kufizim vetëm në gjysmë rimorkio lift nuk është e arsyetuar.

Punimet kryesore të kësaj faze kanë të bëjnë me suvatim, gletim, fasadë, ngjyrosje, ventilim, panele sendviç, instalime elektrike dhe ngrohje qendrore. Për këto punime, bartja e materialeve mund të bëhet në mënyrë të përshtatshme edhe me kamion me lift.

Shkeljet ligjore:

Neni 7, paragrafët 1, 2 dhe 3 të LPP-së – kufizim dhe reduktim i konkurrencës;

Neni 9, paragrafi 1 i LPP-së – kërkesa nuk rezulton nga nevojat reale të projektit;

Neni 28, paragrafët 2 dhe 7 të LPP-së – specifikim i ngushtë teknik dhe jo funksional;

Neni 51, paragrafi 1 i LPP-së – kriter i panevojshëm për aftësinë teknike;

Neni 19.16 i Rregullores – rrezik favorizimi i operatorëve të caktuar;

Nenet 25.17 dhe 25.18 të Rregullores – kërkesë jo relevante dhe jo proporcionale me objektin e kontratës.

Kërkesa:

Kërkohet që kërkesa për:

“Gjysmë rimorkio lift për bartje të materialeve = min. 1 copë”

të riformulohet në mënyrë funksionale dhe jo kufizuese, si vijon:

“Gjysmë rimorkio lift ose kamion me lift për bartje të materialeve = min. 1 copë”.

Ky riformulim do të siguronte që kërkesa të lidhet me funksionin real të nevojshëm, pra bartjen dhe ngarkim-shkarkimin e materialeve me lift, pa kufizuar operatorët ekonomikë vetëm në një lloj të caktuar të mjetit transportues.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data:29.06.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.06.2026 të parashtruar nga OE NNP CTA shpk, Lipjan lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Perfundimi i puneve ne sallen e sportit ne kuader te SHFMU Ismail Luma ne Lipjan" me nr. të Prokurimit 613-26-4194-5-2-1, Autoriteti kontraktues nxjerr:

V E N D I M

Aprovohet Pjeserisht e Bazuar, kërkesa për ri-shqyrtim OE NNP CTA shpk, Lipjan lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Perfundimi i puneve ne sallen e sportit ne kuader te SHFMU Ismail Luma ne Lipjan" me nr. të Prokurimit 613-26-4194-5-2-1,

AK do te publikoj formularin B54 dhe DT me ndryshime e nevojshme dhe te njejtat do te publikohen ne platformen e Prokurimi sipas LPP-se

Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartpërmendur dhe ndryshimet do te paraqiten ne platformen e prokurimi dhe do njoftoheni me B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara

1. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Pergjigje per pretendimet tuaja:

AK me kujdes ka rishqyrtuar kerkesen tuaj dhe ju njoftojme qe Autoriteti Kontraktues mbetet institucioni kompetent per te vleresuar nese specifikat teknike te propozuara jane proporcionale, te nevojshme dhe ne perputhje me objektivat e procedurës së prokurimit me specifika tjera, si do qe te jete gjatë procesit të rishikimit janë identifikuar mundësi për optimizim dhe qartësim të disa kërkesave teknike, andaj janë reflektuar përmirësime të kufizuara që kontribuojnë në një interpretim më të saktë të specifikave, pa ndikuar në qëllimin dhe kërkesat themelore të projektit,

Kerkesat qe do te ndryshojne jane:

Pretendimi juaj i 3 Eskavator robotik max 500 kg min 1 cope, per kete pretendim AK do te ndryshoj kete kerkese e njejta do te publikohet ne c prokurim me formularin B54

Pretendimi juaj i 4 nuk ekziston si kerkese sepse vetem ka qene i ndryshuar per te cilin eshte i publikuar edhe formulari B54 ne platformen e prokurimi.

Paisjet tjera jane te nevojshme per realizimin e projektit ne fjale dhe realizimin e tij, keto kerkese jane kerkuar nga profesionistet inxhinier nga njesia kerkuese dhe jane te bazuara ne specifikat e ketij projekti.


Keto Pretendime jane aprovuar Pjeserisht te Bazuara

AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato qe u thane me lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankesa mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Bekim Shabani

Drejtor i Prokurimit

Me vendimin e datës 29.06.2026, Autoriteti Kontraktues ka aprovuar vetëm pjesërisht kërkesën tonë për rishqyrtim, duke paralajmëruar publikimin e formularit B54 për korrigjimin e pajisjeve teknike.

Pas publikimit të formularit B54, rezulton se AK ka bërë korrigjim vetëm duke larguar kërkesën për “Eskavator robotik max. 500 kg = min. 1 copë”.

Megjithatë, kërkesat tjera të kontestuara kanë mbetur të pandryshuara, konkretisht:

-Dumper vetëshkarkues në 3 anët me kran dhe lugë ngarkuese min. 4T,

-Cilindër me dhëmbëza me lugë për nivelizim max. 4T,

-Gjysmë rimorkio lift për bartje të materialeve dhe

-Kompresor gjysmë rimorkio min. 1.5T.

Prandaj, edhe pas vendimit të datës **29.06.2026** dhe korrjimit me **B54**, AK nuk i ka eliminuar shkeljet e ngritura, pasi kërkesat e mbetura vazhdojnë të jenë **kufizuese, jo proporcionale dhe të paarsyetuara me paramasën ofertuese.**

Pretendimi nr. 1 –

– Dumper vetëshkarkues në 3 anët i pajisur me kran dhe lugë ngarkuese min. 4T = min. 1 copë

Autoriteti Kontraktues, edhe pas **vendimit të datës 29.06.2026** dhe publikimit të **formularit B54**, nuk e ka larguar këtë kërkesë, por e ka lënë të pandryshuar. Kjo kërkesë mbetet **jo proporcionale, kufizuese dhe e paarsyetuar**, pasi AK nuk ka dëshmuar se cilat pozicione konkrete të paramasës ofertuese e bëjnë të domosdoshme një pajisje kaq specifike.

Pajisja e kërkuar përfshin disa funksione të kombinuara në një makineri të vetme: **vetëshkarkim në tri anë, kran hidraulik dhe lugë ngarkuese.**

Foto – Ilustrim teknik i pajisjes së kërkuar nga AK

DUMPER VETSHKARKUES NE 3 ANET I PAISUR ME KRAN DHE LUGE NGARKUESE

MIN 4 TONA



- Kapaciteti ngarkimit: min 4 Ton
- Vetshkarkues ne 3 anet
- Anash majtas
- Anash djathtas
- Mbrapa
- Kran hidraulik
- Kapaciteti ngritjes: 1500 kg
- Rrezja maksimale: 6.0 m
- Luge ngarkuese frontale
- Motor i fuqishem diesel
- Sistem frenimi hidraulik
- Pesha totale e lejuar: ≥ 7.5 Ton



DIMENSIONET KRYESORE	
Gjatësia totale	6.200 mm
Gjerësia totale	2.200 mm
Lartësia totale	2.700 mm
Baza e rrotave	2.600 mm
Kapaciteti ngarkimit	min 4 Ton
Pesha bosh	4.500 kg



Nga fotografia dhe specifikat teknike shihet se nuk kemi të bëjmë me pajisje të zakonshme ndërtimore, por me makineri të veçantë dhe të kombinuara. Kërkimi i një pajisjeje të tillë, pa lejuar pajisje ekuivalente, kufizon konkurrencën dhe mund të favorizojë operatorë të caktuar.

Kjo është në kundërshtim me **nenin 7 të LPP-së**, që kërkon trajtim të barabartë dhe konkurrencë të lirë; **nenin 9 të LPP-së**, pasi kërkesa nuk rezulton nga nevojat reale të projektit; **nenin 28 të LPP-së**, sepse specifikimi është i ngushtë dhe jo funksional; si dhe **nenin 51 të LPP-së**, pasi vendos kriter teknik të panevojshëm për aftësinë profesionale. Gjithashtu, kërkesa është në kundërshtim me **nenin 19.16** dhe **nenet 25.17 dhe 25.18 të Rregullores**, pasi nuk është relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Prandaj, kërkojmë nga **Paneli Shqyrtues i OSHP-së** që këtë pretendim ta vlerësojë si të bazuar dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që kërkesën për **“Dumper vetëshkarkues në 3 anët i pajisur me kran dhe lugë ngarkuese min. 4T = min. 1 copë”** ta largojë në tërësi nga Dosja e Tenderit.

Pretendimi 3

– Cilindër me dhëmbëza me lugë për nivelizim

utoriteti Kontraktues, edhe pas **vendimit të datës 29.06.2026** dhe publikimit të **formularit B54**, nuk e ka larguar këtë kërkesë, por e ka lënë të **pandryshuar**.

Kjo kërkesë mbetet **jo proporcionale, kufizuese dhe e paarsyetuar**, pasi AK nuk ka dëshmuar se cilat pozicione konkrete të paramasës ofertuese e bëjnë të domosdoshme kërkesën për **cilindër me dhëmbëza të pajisur edhe me lugë për nivelizim**.

Pajisja e kërkuar përfshin dy funksione të kombinuara në një makineri të vetme: **ngjeshje me cilindër me dhëmbëza dhe nivelizim me lugë**.

Foto nr1 – Ilustrim teknik i pajisjes së kërkuar nga AK



Nga fotografia nr1 shihet se bëhet fjalë për **pajisje të rëndë ndërtimore**, e cila zakonisht përdoret për punime infrastrukturore, ngjeshje të terrenit dhe nivelizim të sipërfaqeve të mëdha. Ndërsa ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me **përfundimin e punëve në sallën e sportit**, ku punimet janë kryesisht përfundimtare dhe instalative.

Kjo është në kundërshtim me **nenin 7 të LPP-së**, pasi kufizon konkurrencën; **nenin 9 të LPP-së**, pasi kërkesa nuk rezulton nga nevojat reale të projektit; **nenin 28 të LPP-së**, sepse specifikimi është i ngushtë dhe jo funksional; si dhe **nenin 51 të LPP-së**, pasi vendos kriter teknik të panevojshëm. Po ashtu, kërkesa bie ndesh me **nenin 19.16 dhe nenet 25.17 dhe 25.18 të Rregullores**, pasi nuk është relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Prandaj, kërkojmë nga **Paneli Shqyrtues i OSHP-së** që këtë pretendim ta vlerësojë si të bazuar dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që kërkesën për **“Cilindër me dhëmbëza i pajisur edhe me lugë për nivelizim max. 4T = min. 1 copë”** ta largojë në tërësi ose ta riformulojë në mënyrë funksionale, duke lejuar **pajisje ekuivalente për ngjeshje dhe nivelizim**.

Pretendimi 5

– **Kompresor gjysmë rimorkio min. 1.5 T**

Autoriteti Kontraktues, edhe pas **vendimit të datës 29.06.2026** dhe publikimit të **formularit B54**, nuk e ka larguar këtë kërkesë, por e ka lënë të **pandryshuar**.

Kërkesa për kompresor gjysmë rimorkio që tërhiqet min. 1.5T është jo proporcionale, kufizuese dhe e paarsyetuar, pasi asnjë pozicion në paramasën ofertuese nuk ka të bëjë me thyerje, demolim apo punime të rënda, për të cilat zakonisht përdoret kjo pajisje.

Foto nr. 1 – Kompresor gjysmë rimorkio që tërhiqet



Nga fotografia nr 1 shihet se bëhet fjalë për **pajisje mobile të rëndë**, e cila përdoret kryesisht për **thyerje, demolim dhe punime të rënda ndërtimore**. Mirëpo, objekti i këtij aktiviteti të prokurimit ka të bëjë me **përfundimin e punëve në sallën e sportit**, ku punimet janë kryesisht përfundimtare dhe instalative, prandaj kjo kërkesë nuk lidhet me **nevojat reale të projektit**.

Rrjedhimisht, kjo kërkesë bie ndesh me **nenin 7, nenin 9, nenin 28 dhe nenin 51 të LPP-së**, si dhe me **nenin 19.16 dhe nenet 25.17 dhe 25.18 të Rregullores**, pasi nuk është relevante, proporcionale dhe krijon **kufizim të panevojshëm të konkurrencës**.

Prandaj, kërkojmë nga **Paneli Shqyrtues i OSHP-së** që këtë pretendim ta vlerësojë si të bazuar dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që kërkesën për **“Kompresor gjysmë rimorkio që tërhiqet min. 1.5T = min. 1 copë”** ta largojë në tërësi nga Dosja e Tenderit.

Pretendimi 6

– **Gjysmë rimorkio lift për bartje të materialeve**

Autoriteti Kontraktues, edhe pas **vendimit të datës 29.06.2026** dhe publikimit të **formularit B54**, nuk e ka larguar këtë kërkesë, por e ka lënë të **pandryshuar**.

Kërkesa për **gjysmë rimorkio lift për bartje të materialeve** është **jo funksionale, jo proporcionale dhe e paarsyetuar**, pasi kjo pajisje shërben vetëm për **bartje dhe ngarkim-shkarkim të materialeve**, por jo për **ngritjen dhe vendosjen në pozitën e projektuar** të elementeve të rënda konstruktive.

Në paramasën ofertuese janë paraparë punime që lidhen me **konstruksinin e kulmit**, përkatësisht ngritjen dhe montimin e **kapriatave** dhe **paneleve të kulmit**. Këto materiale kanë peshë të konsiderueshme dhe kërkojnë pajisje adekuate për ngritje në lartësi dhe vendosje precize. Për këtë arsye, pajisja e përshtatshme do të ishte **kran ose autovinç**, e jo gjysmë rimorkio lift.

Foto nr.1 – Gjysmë rimorkio lift për bartje të materialeve



Nga fotografia nr1 shihet se kjo pajisje është për bartje dhe ngarkim-shkarkim, por **nuk mund të realizojë ngritjen dhe vendosjen e kapriatave dhe paneleve të kulmit në pozitën e projektuar**.

Foto nr. 2 – Kran/autovinç gjatë montimit të konstruksinin të kulmit



Foto nr. 3 – Montimi i kapriatave në sallë sportive



Fotot nr. 2 dhe nr. 3 janë realizuar në **sallën sportive në fshatin Banullë, AK Lipjan**, në projekt të ngjashëm, me punime të kryera nga **NNP “CTA” sh.p.k.**. Nga këto foto shihet qartë se për montimin e kapriatave dhe elementeve të kulmit është përdorur **kran/autovinç**, pasi vetëm kjo pajisje mundëson ngritjen dhe vendosjen e sigurt e precize të materialeve të rënda në lartësi.

Prandaj, kërkesa e AK-së për **gjysmë rimorkio lift** nuk përputhet me nevojat reale të projektit dhe bie ndesh me **nenin 7, nenin 9, nenin 28 dhe nenin 51 të LPP-së**, si dhe me **nenin 19.16 dhe nenet 25.17 dhe 25.18 të Rregullores**, sepse nuk është relevante, proporcionale dhe funksionale me objektin e kontratës.

Kërkojmë nga **Paneli Shqyrtues i OSHP-së** që këtë pretendim ta vlerësojë si të bazuar dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që kërkesën për **“Gjysmë rimorkio lift për bartje të materialeve = min. 1 copë”** ta largojë ose ta zëvendësojë me kërkesë funksionale për **kran/autovinç** adekuat për ngritjen dhe montimin e kapriatave dhe paneleve të ulmit.

VENDIM

APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE **“N.N.P. CTA”shpk** lidhur me tenderin **Perfundimi i puneve ne sallën e sportit ne kuader te SHFMU Ismail Luma ne Lipjan** me nrp: **613-26-4194-5-2-1**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e **Perfundimi i puneve ne sallën e sportit ne kuader te SHFMU Ismail Luma ne Lipjan** dhe lënda të kthehet në **RI-VLERËSIM**.

AK-së të i kërkohet që Ri-vlerësimin ta bëjë bazuar te largoj kriteret diskriminuese gjate paraqitjes se njoftimit per kontrate dhe te na mundësoj te ofertojm edhe ne si **OE “NNP”CTA”shpk dhe OE tjerë qe kan interes per kete tender.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, shpenzime përgatitore në aspektin teknik për kontratë. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani serioze, dhe me një përvojë të madhe në fushën e ndërtimeve.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Ne i kemi bashkangjitur Ankesës tonë dokumentet e renditura më poshtë:

- Një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë”
- Një kopje të publikimit për “Njoftimi mbi Vendimin e AK”
-

Vërejtje: Të gjitha pretendimet tona mbështeten me fakte që i gjeni të bashkangjitura kësaj ankese por edhe në dokumentacionin e AK

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*